



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji Turke

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare
Viti / Semestri: Viti II , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor - Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të marrë njohuritë bazë të lëndës së Morfologjisë Turke. Të njohë rregullat e fjalëformimit në gjuhën turke. Të dallojë pjesët e ligjëratës në gjuhën turke. Të njohë rregullat e sistemit emëror dhe foljor të gjuhës turke.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të merret me fjalëformimin e emrit në gjuhën turke.
2. Të merret me fjalëformimin e foljes në gjuhën turke.
3. Të merret me fjalët e prejardhura dhe të përbëra.
 - Të gjejë lehtësisht pjesët e ligjëratës në një analizë morfologjike.
 - Të kuptojë strukturën e fjalës në gjuhën turke.
 - Të dallojë morfemën, rrënjën, temën dhe prapashtesat në gjuhën turke.